



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:286958

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05590394

C.nr. 1090/2023

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh. Sh. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fis Murati, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit në emër të inflacionit, jashtë seance gjyqësore, më datë 18.04.2024, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses Sh. Sh. nga, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëses në emër të inflacionit për vitin (*janar – nëntor*) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumën prej 585.64 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit së tij, më datë 05.12.2023, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin në bazë të inflacionit, në emër të inflacionit për vitin (*janar – nëntor*) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumën prej nga 585.64 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit, neni 35, paragrafi 10. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t'ia kompensojë diferencën në pagë në bazë të inflacionit në shumat e lartëcekura. Shpenzimet e procedurës i ka

kërkuar edhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë, 21.00 ne emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, mirëpo KKAK nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, po ashtu ka theksuar se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, “licenca për mësimdhënësit lëshohet për një periudhë 5 vjeqare ndersa paditësi është me licencë të skaduar dhe të njejtit nuk kan zbatuar udhëzimin administrativ lidhur me vazhdimin e licencës. Po ashtu ka theksuar se Qeveria me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi ka qenë e obliguar që të bëjë rritjen e të hyrave për komunat sidomos për komunën e Kamenicës, në kategorinë e pagave, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia dhe kërkesë padia e paditësve për arsyet e cekura më lartë. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është tërësisht e bazuar.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditëset janë të punësuar pranë të paditurës, as paga bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim e inflacionit vjetor për paditëset. Ndërsa kërkesa e paditësve për shpërblimin në bazë te inflacionit, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: “ Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.”, e në rastin konkret gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, për vitin (janar – nëntor) 2022, për 11.60% të inflacionit, shumën prej 585.64 euro.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “ kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet

vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditëses dhe lartësisë së tij, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 35 paragraf. 10 të kësaj Kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Po ashtu gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / Kontrata e datës 18.04.2017, citohet: “ *Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë* ”, në rastin konkret për vitin (janar – nëntor) 2022.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses në emër të inflacionit mesataren vjetore prej 11.6% për vitin (janar - nëntor) 2022, këto në shumë prej 585.64 euro.

Nga këto arsye, gjykata detyroi të paditurën t’ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit në bazë të inflacionit.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ashtu që ia njohi kërkesën e shpenzimeve sa i përket përpilimit të padisë dhe taksës gjyqësore, si shpenzime të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:286958
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05590394

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1090/23, më datë 18.04.2024

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli, d.v

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.